



In medias res

Komunikimi me adoleshentë

“E ardhmja u takon atyre të cilët besojnë në bukurinë e ëndrrave të tyre”

Eleanor Roosevelt

Vërtetë jeta është si një ëndërr. Bukuria e saj është ardhmëria. Bukuria e saj është fëmija. Jeta e fëmijës është e koncentruar në familje dhe në rrethin e njerëzve me të cilët ata jetojnë. Zhvillimi i fëmijës varet nga kujdesi dhe vëmendja të cilën e marrin ata nga njerëzit në familje. Fëmija zhvillohet fizikisht dhe emocionalisht duke shikuar veprimet e të tjerëve dhe duke marrë pjesë në jetën shtëpiake. Në rritje e sipër fillon të kuptojë gjuhën dhe kështu, edhe krijon aftësi për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e veta.

Duke u rritur, fëmijët fillojnë të bëjnë rrjetin e lidhjeve me njerëz të moshave të ndryshme. Pra, përveç me familjen e ngushtë, ata mësojnë të komunikojnë me njerëz të ndryshëm. Ata kanë nevojë për lidhje të tilla, sepse në atë mënyrë zhvillohen emocionalisht dhe intelektualisht.

Adoleshentët janë pjesa më e ndjeshme e shoqërisë. Një shqetësim i madh për ta është edhe nevoja e tyre për jetë private dhe mundësia për të zhvilluar pavarësinë.

Shpesh të rriturit bëjnë gabime duke menduar se fëmijët e kësaj moshe janë tepër të rinj për të vërejtur se çka ngjan ndërmjet tyre, apo për të komunikuar mendimet dhe ndjenjat e tyre. Shumë të rritur supozojnë se adoleshentët nuk janë të vetëdijshëm për shqetësimet e njerëzve tjerë, e as të prekur nga rreziqet apo përvojat e hidhura, prandaj edhe nuk iu sqarojnë gjëra. Shumë adoleshentë janë të lënë anash pa asnjë shpjegim lidhur me atë pse ekzistojnë errësira dhe dhuna!!!

Ne nga fëmijët në rritje e sipër, presim që të formohen me aftësitë e tyre, për të komunikuar, për të zgjedhur problemet, për të marrë përgjegjësinë, për të kryer obligimet shkollore etj. Por, për disa adoleshentë ky zhvillim shpesh është i ndërprerë. Nëse adoleshentët nuk kanë ndihmë dhe përkrahje, ata mund të shkojnë prapa në arritjet e tyre. Mund të kenë mungesë të përvojave normale sociale dhe mësimore. Mund të kenë vështirësi në mësimnxënie dhe në shoqëri. Andaj, për të gjithë fëmijët-adoleshentë është esenciale prezenca e së paku një personi familjar i cili i siguron kujdes të përhershëm për të. Kjo është më se e rëndësishme për të gjithë adoleshentët të cilët kanë vështirësi të mëdha të besojnë dhe të komunikojnë me secilin njeri me të cilin ata shoqërohen dhe jetojnë.

Të rriturit duhet të ndryshojnë sjelljen kur bisedojnë me adoleshentë në mënyrë që të t’iu ndihmojnë atyre që të relaksohen, e jo të bisedojnë me ta në atë mënyrë që e vështirëson komunikimin; duke përdorë mënyra autoritative apo të ashpra. Të rriturit duhet të përdorin ton të veçantë të zërit, të butë, të qetë apo ton melodik, sepse kjo tregon se i rrituri është i afërt me fëmijën dhe ndihmon atë të ndjehet i sigurt.

Pra, pak më tepër dashuri, përkrahje, ledhatim dhe mirëkuptim, e bëjmë të lumtur secilin fëmijë.

Shkroi: Ardita Kabashi-Hima

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Në kuadër të Programit të MKLSH më 14-15 prill në gjimnazin “Xhevdet Doda”, në Prishtinë është mbajtur seminari i gjashtë. Mësimdhënësit kanë qenë shumë aktiv gjatë trajnimit dhe në fletët e vlerësimit kanë shprehur qartë rëndësinë e madhe të zbatimit të këtij programi në klasat e tyre. Në fund pjesëmarrësit janë njoftuar se gjatë muajit maj do të bëhet monitorimi i tyre në klasa.

EKK

(Edukimi kundër korrupsionit)

■ Më 7-9 prill 2007 ka përfunduar trajnimi në Prizren, në kuadër të programit EKK. Trajnimin e ndoqën 33 mësimdhënës të niveleve të ndryshme. Është me rëndësi të ceket se ky është grupi më i madh i mësimdhënësve që janë trajnuar në kuadër të këtij projekti. Monitorimi i mësimdhënësve në klasa për të vlerësuar performancën e tyre në zbatimin e idesë së luftës kundër korrupsionit është duke u zhvilluar me sukses gjatë muajit prill dhe do të vazhdojë dhe në maj. Certifikimi i mësimdhënësve të Prizrenit do të bëhet më 17 maj 2007.

■ Me 14, 21-22 prill 2007, në kuadër të këtij programi, është mbajtur trajnimi në Gjilan. Në trajnim kanë marrë pjesë 25 mësimdhënës të lëndëve shoqërore, të shkollave të ndryshme të regjionit të Gjilanit. Pas përfundimit të trajnimit ka filluar monitorimi i pjesëmarrësve nëpër klasa. Në fund të këtij monitorimi, përkatësisht me datën 17 maj do të bëhet certifikimi i tyre.

Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin

■ Më 4-5 prill 2007 është mbajtur trajnimi me titull “Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin”. Në trajnim morën pjesë përfaqësues të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, përfaqësues të DKA-së, të OJQ-ve, bizneseve dhe të mediave. Pjesëmarrësit ishin shumë të kënaqur me prezantimet dhe programin e trajnimit. Certifikimi i pjesëmarrësve u bë më 10 prill 2007.

■ Më 18-19 prill 2007 është mbajtur trajnimi në Suharekë. Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve ndihmoi kryeshefi i ekzekutivit të Komunës së Suharekës dhe Drejtori i DKA në Suharekë. Trajnimi u zhvillua në një frymë bashkëpunimi dhe në të përveç përfaqësuesve të komunës së Suharekës, morën pjesë edhe shumë drejtorë të shkollave të mesme dhe fillore. Certifikimi i pjesëmarrësve do të bëhet më 3 maj 2007.

Transparenca, etika dhe masat anti-korrupsion në Arsim

■ KEC në bashkëpunim me Education Support Program (ESP) në Budapest, organizuan në Ohër nga data 25 deri me 27 prill 2007 seminarin me temë: “Transparenca, etika dhe masat anti-korrupsion në Arsim”. Në trajnim morën pjesë përfaqësues të MASHT, MEF, UP dhe OJQ-ve, të cilat merren me parandalim dhe luftimin e korrupsionit. Seminarin e udhëhoqën përfaqësues të UNESCO-s në Paris z. Jacques Hallak, znj. Muriel Poisson, si dhe znj. Elmina Kazimzade, sociologe nga Azerbajxhani. Ky projekt u financua nga ESP në Budapest. Pjesëmarrësit ishin shumë aktiv dhe profesorët vlerësuan se seminari në Kosovë

ishite më i miri ndër 5 seminarët e mbajtura me këtë temë në vendet tjera. Këtë seminar e ndoqën 28 pjesëmarrës, të cilët u certifikuan për pjesëmarrje.



Edukimi për të Drejtat e Fëmijës

■ Muaji prill, ishte muaji i cili në shkollën jopublike "Mileniumi i Tretë", kishte për temë mujore "Të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijës". Andaj, programi "Edukimi për të drejtat e fëmijës" u kujdes që nxënësve të klasave të treta të shkollës Mileniumi i tretë, të ju mbajë nga dy orë mësimi, me qëllim që fëmijët të njihen nga afër me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në mjedisin ku jetojnë.

■ Në kuadër të projektit "Paragjykimet dhe Stereotipat gjinore në tekstet shkollore"

Kanë përfunduar tri punimet:

1. Raporti për studimin e paragjykimeve dhe stereotipave gjinor të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të ulët
2. Raporti për studimin e qëndrimeve të mësimdhënësve për ndjeshmërinë e librave të leximit për barazi gjinore
3. Analiza e librave të leximit nga aspekti I ndjeshmërisë gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët

Të gjitha këto punime i janë dërguar donatorit dhe tani presim edhe botimin e

tyre nga ana e donatorëve. Po ashtu, në kuadër të këtij projekti, do të zhvillohet edhe një Konferencë Rajonale, në Mal të Zi, e cila do të mbahet më 12-13 Maj 2007 ku do të debatohet për punimet e bëra dhe bashkëpunimin e mëtutjeshëm me organizatat e Rajonit.

"Edukimi Multikulturor dhe Multietnik"

■ Ne kuadër të programit "Edukimi Multikulturor dhe Multietnik" ka filluar trajnimi i 20 trajnerëve. Moduli i parë është mbajtur më 19-20 prill, në Gjakovë, dhe deri në fund të muajit maj do të zhvillohen edhe dy module tjera, gjegjësisht 7 ditë trajnimi dhe certifikimi i tyre. Manuali për trajnim është përfunduar dhe së shpejti do të u jepet edhe trajnerëve në shërbim.



Hap pas Hapi

■ Nga data 17 deri me 20 prill, në kuadër të programit Hap pas Hapi u mbajt trajnimi "Ngritja e cilësisë në edukimin e fëmijërisë së hershme". Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin monitoruesit e programit, të cilët monitorojnë realizimin e metodologjisë Hap pas Hapi sipas standardeve të ISSA (Asociacionit Ndërkombëtar të Hap pas Hapit) në edukimin parashkollor dhe fillor. Në trajnim morën pjesë 20 pjesëmarrës. Trajnerë ishin Tatjana Vonta nga Sllovenia

dhe Sanja Haxhar nga Bosnja dhe Hercegovina. Ky trajnim ka edhe dy pjesë tjera, që do të realizohen gjatë muajve maj dhe shtator.

Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim

■ Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBASHK), Shoqatën Kosovare për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijës (KAHCR) dhe Organizatën Ndërkombëtare Hap pas Hapit (ISSA) kanë filluar projektin "Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim" financuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim (EAR).

Ky projekt synon ndërtimin e rrjetit në mes të OJQ-ve lokale në fushën e Edukimit, me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të tyre në aktivitetet për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtës shoqërore. Qëllimi i këtij rrjeti është angazhimi i shtuar për rritjen e pjesëmarrjes në arsim. Kjo do të bëhet me forcimin e kapaciteteve të OJQ-ve lokale, KEC, SBASHK dhe KAHCR që të angazhohen në përfundimin e bashkëpunimit me prindërit, shkollat, autoritet lokale dhe qendrore. Një mori e aktivitetëve është planifikuar që t'i kontribuojë këtij qëllimi, duke përfshirë vizita studimore, trajnime specifike për menaxhim dhe hartim politikash, zhvillime dhe organizim të programeve të trajnimit për anëtarët e organizatave partnere dhe të tjera.

■ Më datën 10 prill filloi aktiviteti i parë i projektit të financuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim "Shoqëria Civile për Pjesëmarrje të Shtuar në Arsim". Aktiviteti i parë i projektit ishte një vizitë studimore në Hungari. Vizita zgjati 5 ditë dhe morën pjesë 17 pjesëmarrës nga të tri organizatat partnere KEC, SBASHK dhe

KAHCR. Mikpritëse ishte organizata tjetër partnere nga Hungaria ISSA.

Dita e parë e vizitës u shfrytëzua për njoftim më të mirë në mes të 4 organizatave partnere, përvojave, vizioneve dhe planeve për të ardhmen. Në fund të ditës u mbajt edhe një prezantim i shkurtër mbi Avokimin nga përfaqësuesi i Civil Society Development Fund. Gjatë kësaj vizite u mbajt gjithashtu edhe një trajnim 2 ditor për Menaxhimin e Ndryshimeve. Ky organizim u mbajt nga organizata Partners Hungary Foundation me trajnerë Tibor Kertesz dhe Eva Deak. Pas trajnimit u mbajt edhe një takim me përfaqësuesen e Local Government & Public Service Reform.



Kjo vizitë u shfrytëzua edhe për takimin e parë të Këshillit Drejtues pasi që ishin përfaqësuesit nga të 4 organizatat partnere. Në takim mungonte përfaqësuesi nga MASHT pasi që nuk ishte pjesëmarrës në këtë vizitë. Në takim u diskutuan aktivitetet e ndërmarra nga fillimi i projektit dhe u sqaruan aktivitetet e planifikuara në gjashtë mujorin e parë të projektit.

Pjesëmarrësit u ndanë të kënaqur nga kjo vizitë studimore.



■ Më datën 4-6 maj mbahet trajnimi Ndryshimi dhe Zhvillimi Organizativ. Trajnimi do të mbahet në KEC nga trajnerët Xhavit Rexhaj dhe Osman Buleshkaj.

Edukimi për të drejtën shoqërore

■ Në kuadër të programit Edukimi për të Drejtën Shoqërore, është mbajtur trajnimi treditor në Regjionin e Prizrenit. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë mësime të Arsimit fillor dhe të mesëm, punëtorë nga Zyra e arsimit si dhe përfaqësues të OJQ-ve. Promovimi i diversitetit njerëzor si vlerë, luftimi i paragjykimëve dhe stereotipeve, kuptimi i shtypjes dhe sistemit të dominimit ishin disa nga objektivat e këtij trajnimi.



Ky program trajnimi i disejnuar nga ekspertë nga Amerika dhe Evropa, ndërsa është përcjellë tek pjesëmarrësit nga trajnerë vendor dhe është mirëpritur nga të gjithë. Grupi ka qenë i përbërë nga grupe të ndryshme etnike nga Regjioni i Prizrenit.

Gjatë muajit maj do të organizohen Trajnimet për Edukimi për të Drejtën Shoqërore në Ferizaj dhe Pejë.

Mbledhja e XI e Bordit Drejtues të KEC

Me 19 prill është mbajtur mbledhja e XI e Bordit Drejtues të KEC. Bordi ka aprovuar Raportin vjetor të punës për vitin 2006, si dhe planin e punës për vitin 2007. Anëtarët e Bordit janë shprehur të kënaqur me aktivitetin e KEC gjatë periudhës së kaluar njëvjeçare dhe kanë dhënë sugjerime konkrete për aktivitete të reja dhe për ngritjen e cilësisë së punës në të ardhmen.

Kryesues i Bordit Drejtues është zgjedhur Bajram Shatri, drejtor i Shtëpisë Botuese "Libri Shkollor". Bordi Drejtues i është falënderuar kryesuesit të deritanishëm, Luan Shllaku për udhëheqje 7-vjeçare të Bordit Drejtues dhe ka shprehur bindjen se do të vazhdojë të jap kontributin e vet si anëtar i organit më të lartë të qeverisjes në KEC.

Përgatiti: Petrit Tahiri